

VENDIM
Nr. 29, datë 24.1.2013

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2013, MIRATUAR PËR
KRYEMINISTRINË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kryeministrisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2013, zëri “Shpenzime korente”, t’i shtohet fondi prej 80 000 000 (tetëdhjetë milionë) lekësh, për përballimin e shpenzimeve për shërbime të lobimit, me qëllim kryesor identifikimin dhe tërheqjen e financimeve shtetërore dhe private në fusha me interes për Shqipërinë nga agjenci të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe nga vende të tjera të botës, si dhe agjenci të tjera ndërkombëtare.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Kryeministria për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha